

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN

Drejtoria Komunale për Prokurim Publik  
VU644-24-3853-5-2-1/C885  
14 Nr. 417/24  
Dt. 08.07.2024

## KONTRATË PUNE

### Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Ilmi Azemi – Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik-së** (në tekstin e mëtejshëm **PORORSITËSI**) , dhe
2. “ **MAK Building “sh.p.k.** me seli në Vushtri, me ARBK : 810689117, të cilët i përfaqëson z. **Kastrit Muzaqi** , në tekstin e mëtejshëm: **KRYESI I PUNËVE**, janë pajtuar të lidhin një kontrate publike për punët e shënuara, si vijon :

Rehabilitimi i sallës në objektin e komunës , me numër identifikues:

Nr. i prokurimit	VU644	2	4	38	5	3	5	2	1
Nr. i brendshëm	VU644	2	4	0	4	0	5	2	1

### Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : rehabilitimi i sallës në objektin e komunës, sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : 644-24-040-521

- 1.1 Afati i fillimit të punimeve është 5 ditë pas nënshkrimit të Kontratës, , në rast se kushtet klimatike vlerësohen të përshtatshme për punë.
- 1.2 Projekti do të realizohet brenda periudhës prej 30 ( tridhjetë ) ditëve nga data e lëshimit të Letrës për fillimin e punimeve, nga Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues.
- 1.3 Kryesi i punimeve ka të drejtë në shtyrje të afatit të kryerjes së punimeve në rast të ndikimit të fuqisë madhore, vonesës së Porositësit në përmbushjen e obligimeve kontraktuese dhe atë për aq ditë sa kanë zgjatur rrethanat që e kanë shkaktuar vonesën.
- 1.4 Nëse Kryesi i Punëve/Shërbimeve, me përgjegjësinë e tij, nuk arrin *t'i përfundoj ndonjë ose të gjitha punët/ shërbimet e kontraktuara brenda afatit kohorë të specifikuar në këtë kontratë*, Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon pas skadimit të afatit të përfundimit të punimeve/shërbimeve sipas kësaj Kontrate dhe datës së përfundimit punëve /shërbimeve të kontraktuara, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,10% në ditë të vlerës së punëve/shërbimeve të pa përfunduara - dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

### Neni 2 Çmimi

- 2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: 10,454.50€ ( dhjetmijkatërqindpesdhjetekatër/50Euro).



2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen : në pajtim me Situacionet e aprovuara nga Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrës i Menaxherit të Kontratës i Autoritetit Kontraktues.

2.4 Pagesa e fundit do të kryhet pasi Kontraktuesi të ketë përfunduar punimet dhe Komisioni i Pranimit Teknik të ketë lëshuar Raportin për pranimin teknik të punimeve të përfunduara, me Situacion të nënshtrohet nga Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrës i Menaxherit të Kontratës i Autoritetit Kontraktues.

### Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- (f) Plani për menaxhimin e kontratës;
- (g) Procesverbali i mbledhjes së informatave/vizitës se vendit

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

### Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.





4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe<sup>1</sup> në 4 origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për : Autoritetin Kontraktues – Komuna Vushtrri

Për O.E. : " MAK Building "sh.p.k. – Vushtrri

Emri:	Ilmi Azemi	Emri:	Kastrit Muzaqi
Pozita:	drejtor	Pozita:	drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	08.07.2024	Data:	08.07.2024
Vula:		Vula:	

<sup>1</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

# KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: VU644-24-3853-5-2-1/C885

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë : <b>Ligji në fuqi në Republikën e Kosovës.</b>
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë : <b>gjuhët zyrtare në vend.</b>
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është : <b>10 % ( dhjetë përqind) e vlerës së përgjithshme të kontratës.</b> Dokumenti - Polisa e sigurim apo dokument banka të lëshuar nga ndonjë kompani e sigurimeve apo bankë të licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës me afat validiteti për kohëzgjatjen e periudhës prej 65 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.
	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat];</i> (b) <i>humbje ose dëmtim i Pajisjeve [shëno shumat];</i> (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>10000</i> (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>5000</i> (ii) të personave të tjerë: <i>5000,00</i>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda <b>Katër (4)</b> ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është : konform planit dinamik të dorëzuar sipas afatit të përcaktuar paraprakisht në pikën II.3 të Njoftimit për Kontratë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë : <b>30 ( tridhjetë ) ditë</b> pas nënshkrimit të kontratës .
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: sipas Planit Dinamik , por jo më gjatë se afat i përcaktuar paraprakisht në pikën II.3 të Njoftimit për Kontratë. - fillimi i punimeve: 5 (pesë) ditë pas nënshkrim të kontratës, në rast se kushtet klimatike vlerësohen të përshtatshme për punë.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <b>0,10 % të çmimit përfundimtar të Kontratës, për ditë të vonuar.</b>  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është <b>10% e Çmimit final të Kontratës.</b>

Regjistri i punës	20.1	Kontraktuesi – Kryesi i Punimeve dhe Menaxheri i Projektit i Autoritetit Kontraktues do të mbajnë Librin e Punës dhe Librin Ndërtimor, gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të kontratës, për të evidentuar të gjitha përshkrimet e punimeve të ekzekutuara në objekt, për të konfirmuar sasinë dhe cilësinë e materialeve të përdorura në objekt – vend punishte, gjithashtu për të evidentuar ecurinë e punimeve, pengesat eventuale, aktivitetet e ndërmarra për eliminimin e pengesave të shfaqura, kohëzgjatjen e kohës sa kanë zgjatur pengesat dhe në fund, pas përfundimit të punimeve, për të dhënë një Rekapitulim të ecurisë së punimeve përmes të dhënave në shifra dhe data.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit: do të emërohet me vendim të veçantë nga Zyrtari Kryesor Administrativ i Autoritetit Kontraktues, pas nënshkrimit të kontratës. Do të jetë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe mbikëqyrjen e cilësisë, sasisë dhe përshtatshmërisë së punimeve në objekt, në pajtim me dispozitat e saktësuara si në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës dhe detyrat e përshkuara në vendimin mbi emërimin.
Pagesa	24.1	Pagesat do të bëhen sipas situacioneve të prezantuar nga Menaxheri i kontratës.  Pagesa do të kryhet në afatin sa më të shkurtër kohorë, por jo më gjatë se 30 ditë nga data e pranimit dhe evidentimit të faturës nga zyrtari përgjegjës për pranim dhe protokolim të faurave i AK-së .
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: N / A
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: N / A
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë konform Planit dinamik por jo më gjatë se Plani dinamik i përcaktuar në pikën H.3 të Njoftimit për Kontratë.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është : Periudha garantuese e defekteve është : 24 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm në shumë prej 10% të vlerës së përgjithshme të kontratës, për defektet e paraqitura në objektet.  Dokumentit – Polisa e sigurimit apo dokument bankar të lëshuar nga një bankë apo kompani e sigurimeve e licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës për kualitetin e punëve me afat validiteti për kohëzgjatjen e periudhës prej 24 muaj nga data e pranimit teknik.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është : përqindja e vlerësuar e punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Konform nenit 42 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, në pajtim me ligjin në Kosovë.

**Shënim:** Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G. Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin 0%, 8%-apo-18%, Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy numra pas presëfjes dhjetore

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSH)-€	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
<p>Vërejtje: Pasi që demollimi dhe renovimi është paraparë të bëhet në pjesën e jashtme dhe te mbrendshme të objektit sipas projektit, gjatë demollimit dhe renovimit duhet të bëhet izolimi dhe kufizimi I zonës së caktuar për demolim dhe renovim në mënyrë që të mos pengohet mbarëvajtja funksionale e objekteve perreth.</p> <p>Gjate punëve te demollimit punekryesi duhet te kete kujdes qe te mos demtoj pjese tjera te cilat nuk jane parapare per demolim. Cdo demtim nga punekryesi, obligohet qe ta riparoj dhe ta kthej ne gjendje fillestare.</p> <p>Pas perfundimit te punëve PUNEKRYESI eshte i obliguar qe te rregulloj, nivelizoj, pastroj dhe ti kthej si ne gjendje fillestare te gjitha sipërfaqet e jashtme te cilat jane demtuar gjate procesit te punimeve.</p> <p>Sqarim: Ne te gjitha pozicionet parashihet FURNIZIMI ME MATERIAL, KRYERJA E PUNEVE dhe SKELERIA E NEVOJSHME. Tek punet demoluese, mbeturinat te dergohen ne deponi ku e cakton komuna, kurse materialet qe mund te duhen ne te ardhmen, lokacionin e deponimit e cakton organi mblkeqyres. Gjate gerrimit, materiali i pa-nevojshem te dergohet ne deponin qe e cakton komuna.</p>									
<p><b>PUNET DEMOLUESE:</b></p> <p>Gjate demollimit te objektit, te meren masat e sigurise, te kihet kujdes qe te mos lendohet ndonje punetor apo pale tjeter, te mos demtohen makineri e automjete. Gjate demollimit te behet vazhdimisht ujitja, nese eshte e nevojshme qe te mos shkaktohet shume pluhur. Materiali qe transportohet jasht te transportohet sigurt, te deponohet ne vende legjitime te caktuara nga komuna, gjate transportit te mos zhyten rruget e qytetit eij</p>									
<p><b>I PUNET E RENOVIMIT</b></p>									
1	Furnizimi me material dhe montimi I perdeve, ne sallën e Takimeve, te tipit JALUZZI me fleteza nga druri I bambusit. Fletezat e perdeve duhet te jene 100% rezistente ndaj trezeve te diellit. Gjeresia dhe ngjyra e fletezave te perdeve duhet te percaktohet ne bashkepunim me Organin Mblkeqyres. Ne cnim te kalkulohet edhe tere mekanizmi per mbajtje te perdeve i cili fiksohet ne platon, perforcimet e nevojshme ne platon, si dhe mekanizmi manual per hapje-mbyllje, per kthim ne kend te fletezave te perdeve dhe te gjithë aksesoret e nevojshem.	m <sup>2</sup>	85.00	42.37	18.00	50.00	3601.69	648.31	4250.00

<p>2</p> <p>Furnizimi me material dhe montimi I perdeve, ne sallën e kurorezimeve, perdët te tipit zebra me ngjyra te ndryshme, te cilat shërbejnë edhe për diten dhe natën. Materiali I perdeve duhet te jete pelhure poliesteri 100% me nivel te ulët te mbajtjes se pluhurit dhe me pastrim te lehte. Ne cminn te kalkulohet edhe curre mekanizmi per mbajtje te perdeve i cili fiksohet ne plafon, perforcimet e nevojshme ne plafon.</p>	m <sup>2</sup>	39.00	22.88	18.00	27.00	892.37	160.63	1053.00
<p>3</p> <p>Furnizimi me material permesimi I mureve te knaufit me glet, gerryerja e sipërfaqeve te mureve pas patinimit dhe ngjyrojja me ngjyre te bardhe ne dy shtresa. Ne cminn te kalkulohet edhe gerryerja dhe heqja e sipërfaqeve te demtuara te mureve, si dhe materialet tjera te nevojshme per izolim dhe rregullim te mureve.</p>	m <sup>2</sup>	41.00	7.20	18.00	8.50	295.34	53.16	348.50
<p>4</p> <p>Furnizimi dhe montimi I Projektorit me montim ne plafon "Standard Long Throw" se bashku me mekanizmin montues ne plafon dhe me te gjitha paisjet e nevojshme. Ne cminn te kalkulohet edhe furnizimi me pelhuren e bardhe per shfaqje te imazhit te projektorit me te gjithë mekanizmin e nevojshem per hapje-mbyllje te pelhures dhe mekanizmin levizes me rrota.</p>	copë	2.00	360.17	18.00	425.00	720.34	129.66	850.00
<p>5</p> <p>Furnizimi me material dhe montimi I Smart TV (TV LED) me permasa 75" (189 cm diagonale) te prodhuesit LG, SAMSUNG, SONY apo te ngjashem, me keto karakteristika: - rezolucioni: 4K Ultra HD - zerimi: 20W - marresi: Wi-Fi, HDMI, USB, Optical Ne cminn te kalkulohet edhe mekanizmi levizes me rrota per montimin e TV dhe levizjen ne pozicione te caktuara. Mekanizmi duhet te jete adekuat per madhesine dhe peshen e TV-se.</p>	copë	1.00	636.44	18.00	751.00	636.44	114.56	751.00
<p>6</p> <p>Furnizimi me material dhe montimi I tavolines per PC(kompjuter apo llapop). Tavolina duhet te jete me mekanizmin levizes me rrota. Konstruksioni I tavolines duhet te jete nga metal, ndersa pjesa e sipërme per vendosjen e PC nga druri. Lartesia e tavolines duhet te jete adekuate per pune ne kembë.</p>	copë	1.00	275.42	18.00	325.00	275.42	49.58	325.00

7	<p>Lloji i njësisë së brendshme të montuar në tesh Telekomande Telekomanda Gama e temperaturës së funksionimit në modalitetin e ngrohjes (°C) -15-24 Gama e temperaturës së funksionimit në ftohje (°C) -15 -43 Gama e cilësimit të temperaturës °C 16-30 Modaliteti i funksionimit Ftohësi inverteror R32 Funksioni i menorjes Pozicioni i grilës 2-ë kullim majtas ose djathtas EER 2,98 Klasa e efikasitetit të energjisë - ngrohje A+ Klasa e efikasitetit të energjisë - ngrohje A+ Niveli i shpejtësisë së ventilatorit të brendshëm 7 Niveli i shpejtësisë së ventilatorit të jashtëm poë 3 Cool Btu/h) 18000 Poëer ngrohje (Btu/h) 18000 Kapaciteti ftohës 5 kë Telekomanda si termostat dhome Ngrohje poëer (Btu/h) 12000 Tensioni (V) 220-240 V Fuqia minimale e audios 63 dB(A(Heating) poëer 7100 ë Stand-bya poëer konsumi 1 ë Frekuenca 50 Hz Ftohje poëer 6500 ëa 3 Ngarkesa e ftohësit 1.3 kg Presioni minimal i zërit 39 dB(A)2x10-5Pa Presioni maksimal i zërit 48 dB(A) 5 në lidhje 2x10- Lidhja e rrymës në ftohje 2060 ë Rrjedha e ajrit - min 750 m³ Rrjedha e ajrit - max 1100 m³ Diametri i tubit të lëngut 9.53 mm Diametri i tubit të gazit 16 mm Gjatësia maksimale e tubit 15 m Diferenca maksimale në lartësi 5 m Rryma nominale - ftohje 9.2 - rryma nxehtëse nominale9. amp Ratio SEER - cooling 3.2 Ratio SCOP - ngrohje 4 COP 3,3 Presioni minimal i zërit 39 dB(A)2x10-5Pa Presioni maksimal i zërit 48 dB(A)2x10-5Pa Wi-Fi funksionimi</p>	copë	1.00	1128.81	18.00	1332.00	1128.81	203.19	1332.00
8	Furnizimi me material dhe montimi I folles sw padukshme nw dritaret tek ndarja e sallës se madhe dhe zyra e dytsore	m²	16.00	11.86	18.00	14.00	189.83	34.17	224.00

<p>9</p> <p>Lloji i njesisë së brendshme të montuar në tëh Telekomandë Telekomanda Gama e temperaturës së funksionimit në modalitetin e ngrohjes (°C) -15-24 Gama e temperaturës së funksionimit në ftohje (°C) -15 -43 Gama e cilësimit të temperaturës °C</p> <p>16-30 Modaliteti i funksionimit Ftohësi inverteror R32 Funksioni i memorjes Pozicioni i grilës 2-ë kullim majtas ose djathtas EER 2,98 Klasa e efikasitetit të energjisë - ngrohje A+ Klasa e efikasitetit të energjisë - ngrohje A+ Niveli i shpejtësisë së ventilatorit të brendshëm 7 Niveli i shpejtësisë së ventilatorit të jashtëm poë 3 Cool Btu/h) 24000 Poëer ngrohje (Btu/h) 24000 Kapaciteti ftohës 5 kë Telekomanda si termostat dhorme Ngrohje poëer (Btu/h) 12000 Tensioni (V) 220-240 V Fuqia minimale e audios 63 dB1(Heating) poëer 7100 ë Stand-bya poëer konsumi 1 ë Frekuenca 50 Hz Ftohje poëer 6500 ëa 3 Ngarkesa e ftohësit 1.3 kg Presioni minimal i zërit 39 dB(A)2x10-5Pa Presioni maksimal i zërit 48 dB(A) 5 në lidhje 2x10-Lidhja e trymës në ftohje 2060 ë Rrjedha e ajrit - min 750 m³ Rrjedha e ajrit - max 1100 m³ Diametri i tubit të lëngut 9.53 mm Diametri i tubit të gazit 16 mm Gjatësia maksimale e tubit 15 m Diferenca maksimale në lartësi 5 m Rryma nominale - ftohje 9.2 - rryma nxehtëse nominale9. amp Ratio SEER - cooling 3.2 Ratio SCOP - ngrohje 4 COP 3.3 Presioni minimal i zërit 39 dB(A)2x10-5Pa Presioni maksimal i zërit 48 dB(A)2x10-5Pa Wi-Fi funksionimi</p>	<p>copë</p>	<p>1.00</p>	<p>1119.49</p>	<p>18.00</p>	<p>1321.00</p>	<p>1119.49</p>	<p>201.51</p>	<p>1321.00</p>	
<b>TOTALI PERGJITHSHEM ME TVSH</b>							<p>8,839.75</p>	<p>1,594.75</p>	<p>10,454.50</p>

**IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)**

<b>EMRI I OE:</b>	Mak-Building SH.P.K.
<b>EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:</b>	Kasrri Muzaqi
<b>NËNSHKRIMI:</b>	
<b>DATA:</b>	14.05.2024
<b>VULA:</b>	